

NJOFTIM PËR KËRKIM KANDIDATURASH PËR NDJEKJE KURSI

1	Titulli i kursit	Kursi EOD, Niveli I-rë
2	Procedura për pranim në Kurs	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kontrolli fiziko-shëndetësor (Pranë NJMU sipas formatit i cili kryhet për kontingjentet që shkojnë në Mision). 2. Testi fizik (Sipas Rregullores së Testimit Fizik të FA në fuqi). 3. Testi me shkrim i formimit të përgjithshëm ushtarako-civil (Për kandidatët Oficerë rezultati të jetë mbi 7.5) 4. Intervista (Do të konsistojë në pyetje nga ana e formimit psikologjik dhe social të kandidatit)
3	Kritere të përgjithshme	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të jetë shtetas shqiptar. 2. Të jetë ushtarak aktiv në Forcat e Armatosura të RSH-së. 3. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm në të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen. 4. Të mos jetë bartës i virusit HIV dhe Hepatit B; të mos ketë kaluar sëmundje të zemrës, veshkave, mëlçisë dhe mushkërive. 5. Të jetë me gjatësi trupore 170 cm e lart, femrat mbi 160 cm. 6. Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike
4	Kriteret për oficerët	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të jetë nga grada N/Toger deri Toger. 2. Mosha maksimale (N/Toger/Toger deri 28 vjeç). 3. Nota mesatare e kursit institucional të fundit të jetë mbi 8. 4. Të ketë minimalisht nivel të gjuhës angleze niveli 2/2/2/2 e lart sipas STANAG 6001 ose 75 pikë e lart sipas ALCPT. 5. Të mos ketë masa disiplinore aktive (të jetë i rehabilituar) dhe të jetë vlerësuar në vlerësimet vjetore shumë mirë dhe shkëlqyeshëm për 2 vitet e fundit. 6. Të ketë njohuri bazë të programeve kompjuterike. 7. Preferohen me njohuri në gjuhët e dyta
5	Kriteret për Nënoficerët	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të jetë nga grada N/Tetar deri në Rreshter. 2. Për Nëntetar mosha maksimale 33 vjeç, për Tetar mosha maksimale 37 vjeç dhe për Rreshter mosha maksimale 43 vjeç. 3. Nota mesatare e kursit institucional të fundit të jetë mbi 8. 4. Të kenë minimalisht nivel të gjuhës angleze niveli 1/1/1/1 sipas STANAG 6001 ose 55 pikë e lart sipas ALCPT. 5. Preferohen me arsim të lartë (bachelor) dhe njohuri në gjuhët e dyta. 6. Të mos ketë masa disiplinore aktive (të jetë i rehabilituar) dhe të jetë vlerësuar në vlerësimet vjetore shumë mirë ose shkëlqyeshëm për 2 vitet e fundit.
6	Kriteret për ushtarët	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mosha maksimale 28 vjeç. 2. Të mos ketë masa disiplinore aktive (të jetë i rehabilituar) dhe të jetë vlerësuar në vlerësimet vjetore shumë mirë ose shkëlqyeshëm për 2 vitet e fundit. 3. Nota mesatare e gjimnazit të jetë mbi 6. 4. Preferohen me arsim të lartë (bachelor) dhe njohuri në gjuhët e dyta.
7	Dokumentacioni që duhet të plotësohet	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkesë personale me shkrim e nënshkruar nga kandidati, në të cilën të

		<p>jenë shkruar arsyet përse kandidon për kryerjen e kursit EOD niveli I-rë.</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Fotokopje e njehsuar me origjinalin (vulë sekretarie të repartit) të certifikatës dhe listës së notave të kursit të fundit institucional të kryer. 3. Fotokopje e kartës së identitetit. 4. <i>Dëshmi penaliteti.</i> 5. <i>Vërtetim nga prokuroria e rrethit gjyqësor ku kandidati ka gjendjen civile.</i> 6. <i>Vërtetim nga gjykata e rrethit gjyqësor ku kandidati ka gjendjen civile.</i> 7. Vërtetim mjeko-ligjor nga Njësia Mjekësore Ushtarake (NJMU). 8. Fotografji për dokument, me uniformë ushtarake kamuflazh, 2 copë (4x6). 9. Kopje e printuar e dosjes elektronike të personit (e sigluar nga shefi i personelit në repartin ku shërben). 10. Diploma ose certifikata të tjera që vërtetojnë aftësi shtesë,(patentë, dëshmi përdorimi programe kompjuterike etj.) 11. Për oficerët, dëshmi ose certifikata që vërtetojnë aftësi në përdorimin e programeve bazë kompjuterike (word, excel, powerpoint, data-base). 12. Për personelin i cili disponon certifikatë sigurie të vlefshme të dorëzojë një kopje të saj të sigluar nga shefi i zbulimit në repartin ku punon dhe njehsuar me origjinalin. Nuk është i nevojshëm dorëzimi i dokumenteve të kërkuara në numrat 4, 5 dhe 6.
8	Kriteri specialitetit	E pa aplikueshme
9	Periudha e zhvillimit të kursit	Për tu përcaktuar
10	Vendi i zhvillimit të kursit	Qendra Stërvitore e Komandës Mbështetëse, Pezë-Helmës, Tiranë.
11	Afati aplikimit	Deri më datë 24 Janar 2018.
12	Vendi i aplikimit	Pranë degës/seksionit të personelit (G1/S1) në komanda e reparte.
13	Ekivalentimi	Kandidati certifikohet në specialitetin “EOD, Niveli I-rë”.